



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 31, datë 20.11.2024

PËR

MIRATIMIN E LEJES PËR NDRYSHIMIN E PROJEKTIT GJATË NDËRTIMIT PËR
OBJEKTIN: "GREEN COAST II, ZONA G5, REZIDENCIAL-VILA ELITARE 2 KATE,
ME ÇATI DHE KAT NËNTOKË", ME VENDNDODHJE NË PALASË, DHËRMI,
BASHKINË HIMARË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë "Seaside Residence" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit për objektin: "Green Coast II, Zona G5, rezidencial – vila elitare 2 kate, me çati dhe kat nëntokë", me vendndodhje në Palasë, Dhërmi, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë "Seaside Residence" sh.p.k
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave i bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes i jepet kërkuesit vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Himarë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDITH RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
MIRELA KUMBARO PURXHI



ANËTAR/SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 19/04 2025